

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me procesmbajtësen Fatmire Sermaxhaj, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh.I...nga fshati B..., Komuna e V..., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1857/2022, të datës 13.10.2022, dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr.1857/2022, të datës 13.10.2022, më datë 16.08.2023, mori këtë :

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit: **Sh.I...**, i lindur më datë ..., në fshatin B..., Komuna e V..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Është fajtor

Sepse me datë 03.09.2022, në fshatin B..., Komuna e V..., pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit elektrik, nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se, i pandehuri Sh.I..., si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, dhe në këtë mënyrë ka bërë harxhimin e paautorizuar të energjisë elektrike me çka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar, të dëmtuarën KEDS-in, Distrikti në Gjilan, në vlerë prej 93.44€

-Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, 72 të KPRK-s, si dhe nenit 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

### DËNIM ME GJOBË

**I.** Të pandehurit **Sh.I...**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 100(njëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

**II.** Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

**III.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

**IV.** Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit Sh.I...nga fshati Beguncë, Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-ës. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e

urdhërit ndëshkimore, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimit dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimit ndaj të pandehurit Sh.I..., dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimit.

Gjendja faktike vërtetohet nga provat materiale siç janë: procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike në teren me numër 2054170 i datës 03.09.2022, fotografi mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale, sektori i rikthimit të humbjes së kalkulimeve i RH me numër 437323 i datës 05.09.2022 dhe pro-fatura mbi dëmin e shkaktuar DGLHP 2212995 e datës 05.09.2022, gjyqtari konstatoi se i pandehuri Sh.I... nga fshati B., Komuna e V..., ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par 6 lidhur me par.1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP-s, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEGA NË VITI**  
**P.nr.513/2022, Më 16.08.2023**

**Procesmbajtësja**  
**Fatmire Sermaxhaj**

**Gjyqtari,**  
**Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtë.